


RAPORT VLERËSUES - Shtator 2016



GROUP FOR LEGAL
AND POLITICAL
STUDIES

Monitorimi dhe Vlerësimi i Planit Kombëtar të Zbatimit të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit (Janar – Qershor 2016)



PËR GSJP

Grupi për studime juridike dhe politike është institut për studimin e politikave publike, i pavarur, jo-partiak dhe jo-fitimprurës me seli në prishtinë, Kosovë. Misioni ynë është që të zhvillojmë studime kredibile në fushën e politikës, së drejtës, dhe ekonomisë, si dhe të ofrojmë rekomandime politikash që mëtojnë të zgjidhin problemet në fushat e caktuara të politikave publike.

Raport Vlerësues

Monitorimi dhe Vlerësimi i Planit Kombëtar të Zbatimit të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit (Janar – Qershor 2016)

Shtator 2016

© Grupi për Studime Juridike dhe Politike, Prishtinë, Shtator 2016.

Opinionet e shprehura në këtë dokument nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht ato të Fondacionit të Kosovës për Shoqëri të Hapur (KFOS), stafit, bashkëpunëtorëve ose përfaqësuesve të tyre. Të gjitha të drejtat e rezervuara. Asnjë pjesë e këtij botimi nuk mund të riprodhohet ose të transmetohet në çfarëdo forme apo nga çfarëdo mjeti pa leje. Kontaktoni zyrën administrative të Grupit për Studime Juridike dhe Politike për kërkesat e tilla.

Grupi për Studime Juridike dhe Politike

Rr. "Rexhep Luci" 10/5

Prishtinë 10 000, Kosovë

Faqja e internetit: www.legalpoliticalstudies.org

E-mail: office@legalpoliticalstudies.org

Tel/fax.: +381 38 227 944



Ky raport është pjesë e projektit të titulluar “Monitorimi i vazhdueshëm i Planit të Veprimit: Ku qëndron Kosova kundrejt reformës për Integrim Evropian?”, mbështetur nga Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur (KFOS) dhe implementuar nga Grupi për Studime Juridike dhe Politike (GSJP).

This page intentionally left blank

Monitorimi Dhe Vlerësimi i Planit Kombëtar të Zbatimit të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit (Janar-Qershor 2016)

Në Tetor të vitit 2015, Qeveria e Kosovës ka nënshkruar marrëveshjen e parë kontraktuale me Bashkimin Evropian, Marrëveshjen e Stabilizim Asociimit (MSA). Ky hap paraqet një fillim të ri në marrëdhënien e Kosovës me Bashkimin Evropian. Në të njëjtën kohë, përtej simbolikës që bart në politikën ditore, MSA përfaqëson një mori obligimesh që duhet të përmbushen nga të gjitha institucionet e Republikës së Kosovës.

Me qëllim të përmbushjes së suksesshme të obligimeve që rrjedhin nga kjo marrëveshje, Qeveria e Kosovës, më 16 dhjetor 2016, miratoi Planin Kombëtar për Zbatimin e MSA-së (PKZMSA), duke obliguar të gjitha institucionet përgjegjëse sipas programit, i njëjti u miratua edhe në Kuvend më 10 mars 2016, për të kryer detyrat në zbatim të MSA-së. Ky dokument, sic përcaktohet edhe nga Ministria e Integritimit Evropian, është dokumenti kryesor nacional i politikave për aderimin e Kosovës në Bashkimin Evropian.

PKZMSA është planifikuar për pesëvjeçarin e ardhshëm (2016-2021), kështu parasheh reformat afatmesme deri në zbatimin e plotë të MSA-së. Këto reforma janë të ndara në masa legjislative dhe zbatuese, të strukturuar në përputhje me Kriteret e Kopenhagës, në ato Politike, Ekonomike dhe Standardet Evropiane – apo legjislacioni i Acqui-së. Që nga fillimi i vitit 2016, në kuadër të PKZMSA është paraparë edhe Matrica e Masave Afatshkurta – e ndarë në katër periudha, ku secila paraqet një tremujor të vitit 2016 – në të cilën parashihen obligimet kryesore të të gjitha institucioneve brenda këtij viti.

Ndonëse shteti i fundit në rajon që e nënshkruan MSA-në, Kosova mund ta përdor këtë në favor të saj duke mësuar nga përvojat e shteteve fqinje duke mos i përsëritur të njëjtat gabime. Bazuar në eksperiencën e vendeve të tjera të rajonit, zbatimi i MSA-së është një proces i komplikuar, i cili kërkon vëmendje të veçantë nga të gjithë institucionet e Kosovës. Duke pasur parasysh rëndësinë që ka MSA-ja në rrugën drejt BE-së si dhe në zhvillimin e vendit, Grupi për Studime Juridike dhe Politike ka monitoruar punën e institucioneve të Republikës së Kosovës gjatë gjashtëmujorit të parë të 2016 në përmbushjen e obligimeve të dala nga matrica e masave afatshkurtra të PKZMSA-së, dhe ka hartuar matricën e mëposhtme (Tabela 1), me qëllim që të evidentohen arritjet dhe sfidat gjatë këtij procesi.

Thënë këtë, GSJP në vazhden e monitorimit të përmbushjes së obligimeve nga ana e institucioneve, pas përfundimit të cdo periudhe (3 mujore) ka kërkuar informata nga të gjitha institucionet përgjegjëse në lidhje me punën e tyre, ka zhvilluar intervista me zyrtarë të institucioneve të ndryshme duke vlerësuar se sa kanë arritur të përmbushin objektivat e paracaktuara. Në të njëjtën kohë, ka vlerësuar afatet kohore të zbatimit dhe sa të kujdesshëm ishin në procesin e përafërimit të akteve ligjore të Kosovës me korpusin e të drejtës së BE-së, Acquin. Për ta bërë këtë, janë analizuar ligjet dhe aktet nënligjore, si dhe dokumentet strategjike të hartuara/miratuara nga institucionet e Kosovës.

Para se të kalohet të matrica, vlen të përmenden disa nga sfidat gjatë monitorimit dhe të bëhet një vlerësim i përgjithshëm i institucioneve.

Një ndër problemet kryesore të hasura gjatë punës monitoruese, ka qënë refuzimi apo hezitimi i disa institucioneve për të ndarë me ne informacione (informacione këto, të cilat duhet të jenë të disponueshme për publikun) të cilat na mundësonin vlerësimin e punës së tyre. Gjithsesi, GSJP ka arritur të bëjë një vlerësim të përgjithshëm të arritjeve të institucioneve.

Të dhënat nga monitorimi dhe vlerësimi tregojnë se:

- **Aftësia e institucioneve për të hartuar bazamentin ligjor në linjë me Acqui mbetet e ulët.** Kjo është reflektuar posaçërisht në dështimin e miratimit të ligjeve, nga agjenda e paraparë legislative. Konkretisht për këtë gjashëmujor janë miratuar me pak se gjysma e ligjeve të planifikuara.
- **Mungon bashkëpunimi proaktiv ndërinstitucional.** Përgjatë mbledhjes së informatave GSJP ka vërejtur se ndërmjet disa prej institucioneve të cilat ishin paraparë të bashkërendonin aktivitetet e tyre nuk ka pasur asnjë lloj bashkëpunimi. Kjo është reflektuar në dështimin për të përmbushur objektiva që kërkonin punë nga dy apo më shumë institucione.
- **Ndarja e qartë e përgjegjësisë brenda institucioneve dhe organizimi më efikas i burimeve njerëzore.** Gjatë monitorimit, është vërejtur se disa veprime nuk përmbushen fare, që nënkupton se nëse veprimi nuk kryhet brenda kohës së caktuar nga personi/departamenti kompetent ka gjasa që të mos kryhet fare. Kjo praktikë lë të kuptohet se mospërmbushja e obligimeve duhet të monitorohen më me rigorozitet brenda institucioneve dhe se duhet të ketë llogaridhënie të mirëfilltë.
- **Vullneti politik** – Duke pasur parasysh rëndësinë e zbatimit të MSA-së në rrugën e Kosovës drejt Bashkimit Evropian, Qeveria e Kosovës duhet ta konsideroj PKZMSA-në si plan e vetë ditë të punës. Për më tepër, mosmarrëveshjet e muajve të fundit në mes të partnerëve të koalicionit kanë ndikim të drejtpërdrejtë në gatishmërinë e të gjitha institucioneve për të përballuar sfidat që rrjedhin nga MSA-ja.

Sa u përket veprimeve konkrete, rezultatet e mbledhura nga GSJP që vlerësojnë punën e institucioneve të Kosovës në lidhje me zbatimin e Planit të Kombëtar të Zbatimit të MSA-së tregojnë që, këto të fundit, në gjashtë mujorin e parë të vitit 2016 kanë dështuar që të përmbushin plotësisht shumicën absolute të veprimeve që janë paraparë që të realizohen përgjatë kësaj periudhe kohore. Gjegjësisht, vlerësimi tregon që:

- Nga gjithsej 158 veprime, institucionet e Kosovës kanë përmbushur plotësisht vetëm 44 veprime, pra, më pak se 1/3-ën e tyre, apo vetëm 27% të totalit të këtij gjashtë mujori.
- Nga 114 veprimet e ngelura, shumica e tyre janë pjesërisht të përmbushura. Kjo e fundit nënkupton se ato detyrime janë përmbushur pas afatit kohorë të paraparë me PKZMSA, apo në lidhje me ato objektiva që përmbajnë më shumë veprime, vetëm një pjesë e tyre është zbatuar dhe përmbushja e plote e objektivit varet nga përmbushja/zbatimi i veprime tjera të mbetura.
- Marrë parasysh faktin që jo të gjitha institucionet kanë ndarë informacione mbi punën e tyre, ky raport nuk reflekton punën e tyre.

Nga vlerësimi i GSJP-së posaçërisht mund të nxirren përfundimet e dhëna më poshtë:

- Në shumë raste, institucionet e Kosovës nuk kanë arritur që të hartojnë në kohë, apo nuk kanë filluar që të hartojnë ligjet që janë parashikuar që të miratohen në këtë periudhë kohore.
- Vlerësimi i GSJP-së tregon që një numër i madh i institucioneve nuk kanë arritur që të hartojnë legjislacionin sekondar, edhe në ato raste kur ligjet ka vite që ishin miratuar dhe janë në fuqi.
- Në të njëjtën kohë, vlerësimi tregon që institucionet e Kosovës janë të pritura të dështojnë të realizojnë ato objektiva arritja e cilave varet nga puna ndër-institucionale dhe planifikimi afatgjatë.
- Në anën tjetër, sukseset e vetme të institucioneve të Kosovës lidhen me përmbushjen e objektivave që kërkojnë angazhim minimal, për shembull, në lidhje me emërimet e zyrtarëve

në poste të ndryshme publike, mbajtjen e trajnimeve dhe takimeve, si dhe rritjen e numrit të stafit të zyrave të caktuara etj.

- Në lidhje me objektivat e veçanta, siç është rasti me Ligjin për Shoqëritë Tregtare dhe Ligjin për Ndërmjetësim, këto të fundit ende nuk janë dërguar në Kuvend për aprovim.
- Institucionet e Kosovës, në lidhje me Ligjin për Parandalimin e Konfliktit të Interesit të Zyrtarëve të Lartë dhe Ligji për Arsim të Lartë, të cilat janë më të rëndësishëm në raport me shtetin ligjor dhe reformën në fushën e arsimit, kanë dështuar që të miratojnë ato.

Marrë parasysh mungesën e plotë të seriozitetit të institucioneve të Kosovës që të adresojnë kërkesat që dalin nga MSA, GSJP kërkon nga Qeveria e Kosovës që të përmirësoj kontrollin e performancës së institucioneve nën menaxhimin e saj, dhe institucioneve tjera, duke kërkuar nga këto të fundit, që jo vetëm të raportojnë por edhe të plotësojnë objektivat në kuadër të këtij procesi.

Në veçanti, GSJP propozon që Qeveria e Kosovës, si koordinatore dhe udhëheqëse e procesit të zbatimit të MSA-së të:

- Filloj një proces të ri të prioritizimit të objektivave që duhet arritur. Suksesi i institucioneve në fund matet nga aftësia e tyre për të përmbushur objektiva më të rëndësishme, si ligji për Parandalimin e Konfliktit të Interesit dhe ai për Arsim të lartë.
- Qeveria, në ato raste ku zbatimi i objektivave varet nga hartimi apo miratimi i ligjeve të ndryshme, apo nxjerrja e akteve nen-ligjore në lidhje me ligjet që janë në fuqi, duhet që të prioritizoj ato, dhe dështimin i nxjerrjes së tyre në afatet kohore shtesë duhet të njuh përgjegjës. Përgjegjësia e tillë duhet të shtrihet në dy nivele, si në kuptimin e përgjegjësisë politike ashtu edhe asaj administrative në kuadër të procedurave të vlerësimit të performancës dhe disiplinimit të nëpunësve civil (pavarësisht gradës brenda shërbimit).
- Rritja e llogaridhënies së ministrave dhe stafit civil të institucioneve duhet lidhur edhe me përgjegjësitë individuale në kuadër të objektivave të dhëna në PKZMSA. Përderisa institucionet, përgjegjësit e tyre, dhe nëpunësit civil nuk ndihen të obliguara ndaj askujt që të arsyetojnë performacën e tyre në lidhje me përmbushjen e objektivave të PKZMSA-së, vazhdimi i rrugës së integritimeve evropiane mbetet dytësore.

Së fundmi, rritja e bashkëpunimit midis institucioneve dhe shoqërinë civile. GSJP iu bën thirrje institucioneve për një bashkëpunim sa më konstruktiv dhe të përhershëm me shoqërinë civile në proceset e integritimit evropian.

Tabela 1: Vlerësimi përfshin periudhën kohore Janar – Qershor 2016

Nr.	Objektivat/Referencakornizë	Aktet kombëtarë që do të harmonizohen	Aktet e acquis së BE që do të transpozohen	Institucione të përgjegjëse /mbështetëse	Afatet Kohore	Indikatori i performancës brenda periudhës kohore	Performanca	Vlerësimi
1.	Të zbatohen dispozitat e MSA së mbi administratën publike (neni 120)	Ligji për Procedurën e Përgjithshme Administrative (ligji i ri)	Direktiva 2006/123/KE e Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 12 dhjetor 2006 "Për shërbimet në tregun brendshëm"	MAP	K1 - 2016	A është miratuar ligji për procedurën e përgjithshme administrative?	Nuk është miratuar ligji i ri. Ligji është miratuar më 25 maj 2016.	Pjesërisht. Ligji është nxjerrur pas afatit të paraparë.
2.	Zbatimi i Neneve 20, 80 dhe 74 pika 3 të MSA –së	UA për Menyrën e Autorizimit të Trupave për Vlerësim të Konformitetit (akt nënligjor i ri)	Vendimi 768/2008/KE e Parlamentit Evropian dhe Këshillit e datës 9 Korrik 2008 mbi një Kornizë të Përbashkët për Marketingun e Produkteve	MTI MZHE MMPH MSH MBPZHR MPB ARKEP	K1 – 2016	MBPZHR: A këni nxjerrë Udhëzim Administrativ për Menyrën e Autorizimit të Trupave për Vlerësim të Konformitetit (akt nënligjor i ri)?	- Udhëzim Administrativ është miratuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës: Udhëzim Administrativ Nr. 04/2016 për Menyrën e Autorizimit të Trupave për Vlerësim të Konformitetit.	Përmbyshur.
3.	Zbatimi i Neneve 20, 80 dhe 74 pika 3 të MSA-së	UA për njohjen e dokumenteve të huaja për Konformitetin (akt	Vendimi 768/2008/KE e Parlamentit Evropian dhe	MTI MZHE MMPH MSH MBPZ h R MPB ARKEP	K1 – 2016	A është nxjerrur UA për njohjen e dokumenteve të huaja për	Nuk ka arritur të përpilohet UA, dhe pritet që kjo të ndodhë në fund të	I paplotësuar.

		nënligjor i ri)	Këshillit e datës 9 Korrik 2008 mbi një Kornizë të Përbashkët për Marketingun e Produkteve	DK		konformitet?	këtij viti.	
4.	Zbatimi i nenit 89 të MSA-së	Ligji për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Parandalimin e Financimit të Terrorizmit. (ligji i ri)	Direktiva (KE) 2015/849 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 20 Majit 2015 mbi Parandalimin e Përdorimit të Sistemit Financiar për qëllim të Pastrimit të Parave apo Financimit të Terrorizmit.	MF NJIF-K BQK DK PK ATK MIE	K1 - 2016	A është miratuar ligji për parandalimin e pastrimit të parave dhe parandalimin e financimit të terrorizmit? Cili ka qenë kontributi i BQK në përpilimin e Ligjit për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Parandalimin e Financimit të Terrorizmit? Në sa grupe punuese keni marrë pjesë?	Ligji në fjalë nuk është miratuar brenda kohës së paraparë, por më 25 maj 2016. BQK:Divizioni për parandalimin e pastrimit të parave ka marrë pjesë në një grup punues të themeluar nga ana e Ministrisë së Financave dhe udhëhequr nga Njësia Për Inteligjencë Financiare në kuadër të Ministrisë së Financave, në lidhje me Ligjin për Parandalimin e Pastrimit të parave dhe luftimin e financimit të terrorizmit. Në këtë grup punues dhe në çdo organizim	Pjesërisht.

							tjetër ku ne jemi ftuar dhe është diskutuar ky projektligj, ne kemi ofruar kontributin, vërejtjet dhe komentet tona, të cilat kanë qenë në përputhje me rekomandimet dhe direktivat e Bashkimit Evropian dhe standardeve tjera ndërkombëtare të fushës përkatëse.	
5.	Zbatimi i nenit 79 të MSA-së	Ligji për Prokurim Publik Nr. 04/L 042 (plotësimndryshim)	1.Direktiva 2014/25/e BE-së 2.Direktiva 2014/24/e BE-së Parlamentit Evropian dhe Këshillit Evropian mbi Prokurimin Publik që Shfuqizon Diktiven 2004/18/të BE-së 3.Direktiva 2014/25 /e BE-së e Parlamentit Evropian dhe e	MF KRPP OSHP AQP	K1 2016	- A është miratuar plotësim ndryshimi i ligjit për Prokurim Publik?	Është bërë plotësim ndryshimi i ligjit në fjalë brenda kohës së paraparë.	Përmbushur.

			<p>Këshillit e datës 26 shkurt 2014 mbi prokurimet nga subjektet që operojnë në sektorin e ujit, energjisë, transportit dhe sektorëve të shërbimeve postare që shfryqizon Direktivën 2004/17 /të BE -së 4.Direktiva 2007/66 /e BE-së e Parlamentit Evropain dhe e Këshillit Evropian e datës 11 dhjetor 2007 për përmirësimin e efektivitetit dhe procedurave të shqyrtimit për dhënien e kontratave publike.</p>					
6.	Zbatimi i neni51 te MSA -se, pika 1, 2, 3	Ligji Nr.4/L014 për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim (plotesim/ndrysh	<p>Direktiva 4 (për logarit vjetore të disa llojeve të Kompanive) Direktiva 7 (për logarit e</p>	MF MTI ZKM MIE	K1 – 2016	A është miratuar plotësim ndryshimi i ligjit për kontrabilitet, raportim financiar dhe auditim?	Nuk është bërë plotësim ndryshimi i këtij ligji.	plotësuar.



		him)	konsoliduara) dhe Direktiva 8 (mbi miratimin e personave përgjegjës për të kryar auditimet statutore).					
7.	Zbatimi i nenit 51 të MSA -se, pika 1, 2, 3	Aprovimi i ligjit për falimentim (ligj i ri)	Rregullorja (BE) 2015/848 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 20 Maj 2015 mbi Procedurat e Falimentimit	MTI MF MD	K1 2016	- A është miratuar ligji për falimentim?	Nuk është aprovuar ligji për falimentim. Ligji është miratuar në korrik, pra me vonesë.	Pjesërisht.
8.	Zbatimi i nenit 50, 96 dhe aneksit 6 të MSA -së	Rregullorja për Ekspozimet e Mëdha (plotësim ndryshim)	1. Rregullorja Nr. 575/2013 “Mbi kërkesat prudenciale për institucionet e kreditimit dhe shoqëritë investimit”	BQK	K1 2016	- A është bërë plotësimi ndryshimi i rregullores? Sa janë marrë parasysh direktivat e BE-së?	Verzoni i fundit në uebfaqe është 10 maj 2013. Përgjigja: Janë ndryshuar dhe plotësuar.	Pjesërisht.
9.	Zbatimi i nenit 50, 96 dhe aneksit 6 të MSA -së	Rregullorja për menaxhimin e rrezikut kreditor (plotësim ndryshim)	1. Direktiva 2013/36/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 26 Qershor 2013 për qasje në veprimtarinë e institucioneve të kreditit dhe mbikëqyrjen e	BQK	K1 2016	- 1. A është ndryshuar rregullorja ? 2. Sa janë marrë parasysh Direktivat?	Verzoni i fundit i plotësim ndryshimit është ai i 10 Maj 2013. Përgjigja: Janë ndryshuar dhe plotësuar rregulloret.	Pjesërisht.

			kujdesshme të institucioneve të kreditit dhe firmave investuese që kanë ndryshuar Direktivën 2002/87/KE dhe shfuqizuar Direktivën 2006/48/KE dhe 2006/49/KE					
10.	Të zbatohen dispozitat e MSA - së nga neni 109 për politikën audio - vizuale, neni 110 për shoqërinë e informacionit, dhe neni 111 për rrjetet dhe shërbimet e komunikimit elektronik	Rregullorja për shpërndarjen e shërbimeve audio dhe audio -vizuale (akti nënligjor i ri/amandamentuar i Rregullorja e distribuimit të kabllor të programeve radio televizive))	1. Direktiva për Shërbimet Mediale Audio - Vizuale - AVMSD	KPM	K1 – 2016	A është nxjerrur rregullorja për shpërndarjen e shërbimeve audio -vizuale dhe për distribuimin e kabllor të programeve?	Me 14 qershor 2016, KPM ka mbajtur edhe një dëgjim publik lidhur me Draft Rregulloren për Shpërndarjen e Shërbimeve Mediale Audio Vizuale. Pas këtij dëgjimi publik, KPM do të miratojë edhe këtë rregullore, si akti nënligjor i fundit i cili është dashtë amandamentuar pas hyrjes në fuqi të Ligjit për KPM, Nr.04/L-44 dhe në harmoni me direktivën AVMSD.	<i>Paplotësuar.</i>

11.	Të zbatohet neni 102 i MSA -së në fushën e sigurisë ushqimore dhe agroindustrisë	Ligji nr. 03/L - 016 për ushqimin (plotësim ndryshim)	1. Rregullorja nr. 178/2002 e Parlamentit dhe Këshillit Evropian për përcaktimin e parimeve dhe kërkesave të përgjithshme të ligjit për ushqimin, krijimin e Autoritetit Evropian për Siguri Ushqimore dhe parashtrimin e procedurave që i përkasin sigurisë ushqimore	MBPZHR AUV MF MTI	K1 – 2016	Aështë miratuar plotësim ndryshimi i Ligjit për Ushqimin? MBPZHR: Cili ka qenë kontributi juaj në procesin e plotësim ndryshimit të këtij ligji?	Plotësim ndryshimet ende nuk kanë hyrë në fuqi. MBPZHR: Për hartimin e Projektligjit për Ushqimin pjesë të grupit punues kanë qenë edhe zyrtarët e MBPZHR-së. Nuk është realizuar veprimi dhe ka vonesa.	Paplotësuar.
12.	Të zbatohet neni 102 i MSA -së në fushën e sigurisë ushqimore dhe agroindustrisë	Rregullorja për aprovimin dhe regjistrimin e operatorëve të biznesit për ushqim (akt nënligjor i ri)	1. Rregullorja nr. 882/2004 e Parlamentit dhe Këshillit Evropian dhe mbikëmbetësit zyrtarë të kryera për të siguruar verifikimin e pajtueshmërisë me Ligjin për ushqimin e kafshëve dhe ushqimin	AUV	K1 – 2016	Aështë nxjerrur rregullorja për aprovimin dhe regjistrimin e operatorëve të biznesit për ushqim?	Nuk ka përgjigje nga Agjencia për Ushqim dhe Veterinari, por nuk është aprovuar rregullorja.	Paplotësuar.
13.	Të zbatohen dispozitat e MSA - së në fushën e energjisë	Ligji për performancën e energjisë në	1. Direktiva nr. 2010/31/KE për performancën	MMPH MZHE	K1 – 2016	Aështë miratuar ligji për performancën e energjisë?	Nuk është aprovuar. Nuk ka informata mbi	Paplotësuar.

	(neni 114)	ndërtesa (ligj i ri)	energjetike në ndërtesa				fazën në të cilën gjindet.	
14.	Zbatimi i nenit 74 dhe 94 të MSA -së	Rregullorja për mbështetjen emergjente me likuiditet (plotësim ndryshim)	1. Direktiva 2013/36/BE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 26 Qershor 2013 mbi qasjen në veprimtarinë e institucioneve të kreditit dhe mbikëqyrjen e kujdesshme të institucioneve të kreditit dhe firmave investuese, ndryshuar Direktivën 2002/87/KE dhe shfuqizuar Direktivat 2006/48/KE dhe 2006/49/KE	BQK	K1 – 2016	A është bërë plotësim ndryshimi i rregullores? Sa janë marrë parasysh direktivat në fjalë?	Është aprovuar më 30 shtator të 2015.	Përmbushur.
15.	Zbatimi i nenit 82 dhe 106 të MSA -së	Hartimi i Rregullores mbi kërkesat minimale të sigurisë shëndetit në punë për përdorim pajisjeve	Direktiva e Këshillit 89/656/KEE e 30 nëntorit 1989 mbi kërkesat minimale të shëndetit dhe të sigurisë për përdorim nga punëtorët	MPMS	K1 – 2016	A është hartuar rregullorja mbi kërkesat minimale të sigurisë dhe shëndetit në punë për përdorim të paisjeve personale nga të punësuarit?	Është hartuar projektregullorja, dhe do të miratohet deri në fund të muajit maj.	Pjesërisht.

		personale nga të punësuarit	pajisjeve personale mbrojtëse në vendin e punës (Direktiva e tretë individuale brenda kuptimit të nenit 16 (1) të Direktivës 89/391/KEE), 31989L0656					
16.	Zbatimi i nenit 82 dhe 106 të MSA -së	Hartimi i Rregullores mbi kërkesat minimale të sigurisë dhe shëndetit në punë për trajtimin manual të ngarkesave ku ka rrezik veçanërisht nga lëndimi i shpinës për punëtorët	Direktiva e Këshillit 90/269/KEE e 29 majit 1990 mbi kërkesat minimale të shëndetit dhe të sigurisë për trajtimin manual i ngarkesave ku ka rrezik veçanërisht nga lëndimi i shpinës për punëtorët (Direktiva e katërt individuale brenda kuptimit të nenit 16 (1) të Direktivës 9/391/KEE), 31990L0269	MPMS	K1 – 2016	1.A është bërë plotësim ndryshimi i rregullores? 2.Sa janë marrë parasysh direktivat në fjalë?	Eshte hartuar Projektregullja mbi kërkesat minimale të sigurisë dhe shëndetit në punë për trajtimin manual të ngarkesave ku ka rrezik veçanërisht nga lëndimi i shpinës. Projektregullorja do te miratohet ne fund te muajit maj.	Pjesërisht.
17.	Zbatimi i nenit 82 dhe 106 të MSA -së	Hartimi i Rregullores mbi kërkesat	Direktiva e Këshillit 92/58/KEE e 24	MPMS	K1 – 2016	A është hartuar rregullorja për kërkesat minimale	Projektregullorja do te miratohet ne fund te muajit prill	Pjesërisht.

		minimale të sigurisë dhe shëndetit në punë për shenjat në vendet e punës	qershor it1992 mbi kërkesat minimale për sigurimin e shenjave shëndetësore dhe/ose të sigurisë në punë (Direktiva e nëntë individuale brenda kuptimit të nenit 16 (1) të Direktivës 89/391/KEE), 31992L0058			të sigurisë dhe shëndetit në punë për shenjat në vendet e punës?		
18.	Zbatimi i nenit 82 dhe 106 të MSA -së	Hartimi i Rregullores mbi me kërkesat minimale për përmirësimin e sigurisë dhe shëndetit në punë të punësuarve në industrinë mineral - nxjerrjes përmes shpimit	Direktiva e Këshillit e Këshillit 92/91/KEE e 3 nëntorit 1992 lidhur me kërkesat minimale për përmirësimin e sigurisë dhe shëndetit mbrojtjen e punëtorëve në industrinë mineral - nxjerrjen përmes shpimit (Direktiva e njëmbëdhjetë individuale brenda kuptimit të nenit 16 (1) të	MPSM	K1 – 2016	Aëstë hartuar rregullorja mbi kërkesat minimale për përmirësimin e sigurisë dhe shëndetit në punë të të punësuarve në industrinë e nxjerrjes mineraleve përmes shpimit.	Është hartuar projekt rregullorja mbi kërkesat minimale ... dhe do të miratohet në Maj.	Pjesërisht.

			391/KEE), 31992L0091					
19.	Zbatimi i nenit 82 dhe 106 të MSA -së	Hartimi i Rregullores mbi kërkesat minimale për përmirësimin e sigurisë dhe shëndetit në punë mbrojtjen e punëtorëve në industrinë e minerale nxjerrjes nëntokësore dhe sipërfaqe	Direktiva e Këshillit 92/104/KEE e 3 dhjetorit 1992 mbi kërkesat minimale për përmirësimin e sigurisë dhe shëndetit mbrojtjen e punëtorëve në industrinë e minerale nxjerrjes nëntokësore dhe sipërfaqe (Direktiva e dymbëdhjetë individuale brenda kuptimit të nenit 16 (1) të Direktivës 89/391/KEE), 31992L0104	MPMS	K1 – 2016	Aështë hartuar rregullorja mbi kërkesat minimale për përmirësimin e sigurisë dhe shëndetit në punë mbrojtjen e punëtorëve në industrinë e minerale nxjerrjes – nëntokësore dhe në sipërfaqe?	Projektregullorja do te miratohet ne fund te muajit nentor.	Pjesërisht.
20.	Zbatimi i nenit 82 dhe 106 të MSA -së	Hartimi i Rregullores mbi kërkesat minimale për përmirësimin e sigurisë dhe shëndetit në punë të të punësuarve	Direktiva e 1999/92/KE Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 16 dhjetorit 1999 mbi kërkesat minimale për përmirësimin e sigurisë dhe	MPMS	K1 – 2016	Aështë hartuar rregullorja mbi kërkesat minimale për përmirësimin e sigurisë dhe shëndetit në punë të të punësuarve potencialisht në rrezik nga	Projektregullorja do te miratohet ne fund te muajit korrik.	Pjesërisht.

		potencialisht në rrezik nga atmosferat shpërthyesë	shëndetit mbrojtjen e punëtorëve potencialisht në rrezik nga atmosferat shpërthyesë (Direktiva 15 individuale brenda kuptimit të nenit 16 (1) të Direktiva 89/391/KEE),			atmosferat shpërthyesë.		
21.	Zbatimi i nenit 82 dhe 106 të MSA -së	Hartimi i Rregullores mbi kërkesat minimale të sigurisë dhe shëndetit në punë me ekspozimin e të punësuarve ndaj rreziqeve nga dridhja	Direktiva 2002/44/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit të 25 qershorit 2002 mbi kërkesat minimale të shëndetit dhe sigurisë në lidhje me ekspozimin e punonjësve ndaj rreziqeve që lindin nga agjentët fizikë (dridhje) (Direktiva e gjashtëmbëdhjetë individuale brenda kuptimit të nenit 16 (1) të Direktiva 89/391/KEE),	MPMS	K1 – 2016	Aëstë hartuar rregullorja mbi kërkesat minimale të sigurisë dhe shëndetit në punë me ekspozimin e të punësuarve ndaj rreziqeve nga dridhja?	Projektregullorja do të miratohet në fund të muajit korrik.	Pjesërisht.

			32002L0044					
22.	Zbatimi i nenit 82 dhe 106 të MSA –së	Hartimi i Rregullores mbi kërkesat minimale të sigurisë dhe shëndetit në punë në lidhje me ekspozimin e te punësuarve ndaj rreziqeve nga zhurma	Direktiva 2003/10/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit të shkurtit 2003 mbi kërkesat minimale të shëndetit dhe sigurisë në lidhje me ekspozimin e punonjësve ndaj rreziqeve që lindin nga agjentët fizikë (zhurma) 2007/30 / KE, 32003L0010	MPMS	K1 – 2016	Aëstë hartuar rregullorja mbi kërkesat minimale të sigurisë dhe shëndetit në punë në lidhje me ekspozimin e të punësuarve ndaj rreziqeve nga zhurma?	Projektregullorja do te miratohet ne fund te muajit korrik	Pjesërisht.
23.	Zbatimi i nenit 82 dhe 106 të MSA -së	Hartimi i Rregullores mbi mbrojtjen e të punësuarve nga rreziqet që lidhen me ekspozimin ndaj asbestit në vendin e punës	Direktiva 2009/148/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit të nëntorit 2009 mbi mbrojtjen e punëtorëve nga rreziqet që lidhen me ekspozimin ndaj asbestit në vendin e punës, 32009L0148	MPMS	K1 – 2016	Aëstë hartuar rregullorja mbi mbrojtjen e të punësuarve nga rreziqet që lidhen me ekspozimin ndaj asbestit në vendin e punës?	Projektregullorja do te miratohet ne fund te muajit nentor.	Pjesërisht.
24.	Të zbatohen dispozitat e MSA - së në fushën e gjyqësorit (neni 83)	Ligji nr. 03 - L - 057 për Ndërmjetësim (plotësim - ndryshim)	Direktiva 2008/52/KE të Parlamentit Evropian dhe Këshillit të datës	MD	K1 – 2016	Aëstë miratuar ligji për ndërmjetësim?	Lidhur me Projektligjin për Ndërmjetësimin, është në fazën finale dhe se	Paplotësuar.

			21 maj 2008 në Disa Aspekte të Ndërmjetësimit ne Çështjet Civile dhe Komerçiale				planifikohet që drafti final të hartohet deri në mesin e qershorit. Pas kësaj dote organizohet punëtorja e dytë ku do të finalizohet ky projektligj në bashkëpunim me Zyren e BE-se, USAID-in dhe akteret e tjere vendore e te huaj. Ligji nuk është miratuar as në Korrik.	
25.	Të zbatohen dispozitat e MSA - së në fushën e gjyqësorit (neni 83)	Ligji nr. 04 - L - 139 për Procedurën Përmbartimore (plotësim ndryshim)	N/A	MD	K1 – 2016	A janë miratuar plotësim ndryshimet e ligjit për procedurën përmbartimore?	Është hartuar drafti fillestar i projektligjit për Procedurën Përmbartimore dhe është dërguar te ekspertet e FMN-se për komente, pritet që pas marrjes së komenteve nga FMN-ja dhe akteret e tjere, projektligji të finalizohet dhe procedohet në Qeveri.	Paplotësuar.

26.	Të zbatohen dispozitat e MSA - së në fushën e gjyqësorit dhe politikave kundër korrupsion (neni 83 dhe neni 91)	Ligji për Konfiskimin e Pasurisë së Pajustificueshme (ligji ri)	Direktiva nr. 2014/42 /BE për ngrirjen dhe konfiskimin e instrumenteve dhe të ardhurave në BE	MD KPK	K1 – 2016	Aëshhtë miratuar ligji për konfiskimin e pasurisë së pajustificueshme?	Koncept-dokumenti për Konfiskimin e Pasurisë së Pajustificueshme është në finalizim e sipër dhe pritet se shpejti procedimi i tij per shqyrtim dhe miratim ne Qeveri. Pas miratimi te tij, do te fillohet me hartimin e projektligjit per konfiskimin e pasurise se pajustificueshme, bazuar ne opcionin e rekomanduar te konceptdokumenti.	Paplotësuar.
27.	Të zbatohen dispozitat e MSA - së në fushën e gjyqësorit dhe politikave kundër korrupsion (neni 83 dhe neni 91)	Ligji nr. 04/L - 051për parandalimin e konfliktit të interesit (plotësim ndryshim)	N/A	MD AKK KUVENDI	K1 – 2016	Aëshhtë miratuar plotësim ndryshimi i ligjit për parandalimin e konfliktit të interesit?	Projektligji për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, është derguar drafti për komentete EUSR, jemi duke presim qe në koordinim me ta ta finalizojme dhe dergojme per miratim ne Qeveri.	Paplotësuar.
28.	Të zbatohen	Hartimi dhe	N/A	KGJK	K1 –	A janë hartuar dhe	Aktualisht janë	Përmbushur.

	dispozitat e MSA - së në fushën e gjyqësorit (neni 83)	plotësimi të gjitha drafteve të cilat do të përkojnë me sistemin informativ të menaxhimit të lëndëve		GJKATA	2016	plotësuar të gjitha draftet të cilat do të përkojnë me sistemin informativ të menaxhimit të lëndëve?	evidentuar të gjitha rregulloret të cilat përkojnë SML-in dhe është duke u punuar në këto ndryshime.	
29.	Të zbatohen dispozitat e MSA - së në fushën e gjyqësorit (neni 83)	Rregullore për Procedurën e Publikimit të Aktgjykimeve nga të gjitha gjykatat, e miratuar (akt nënligjor i ri)	N/A	KGJK	K1 – 2016	A është miratuar Rregullorja për Procedurën e Publikimit të Aktgjykimeve nga të gjitha gjykatat?	Masa është në realizim e sipër.	Pjesërisht.
30.	Të zbatohen dispozitat e MSA - së në fushën e gjyqësorit (neni 83)	Rregullore për gjyqtarë porot, e miratuar (akt nënligjor i ri)	N/A	KGJK	K1 – 2016	A është miratuar Rregullorja për gjyqtarë porot?	Masa është në realizim e sipër.	Pjesërisht.
31.	Të zbatohen dispozitat e MSA - së në fushën e gjyqësorit (neni 83)	Rregullore për emërim, transferim, gradim, dhe çdo lëvizje të gjyqtarit, e miratuar (akt nënligjor i ri)	N/A	KGJK	K1 – 2016	A është miratuar rregullorja për emërim, transferim, gradim, dhe çdo lëvizje të gjyqtarit?	Masa është në realizim e sipër.	Pjesërisht.
32.	Të zbatohen dispozitat e MSA - së në fushën e gjyqësorit (neni 83)	Rregullore për certifikimin e përkthyesve dhe interpretëve gjyqësor në procedura	N/A	KGJK GJKATAT	K1 – 2016	A është nxjerrur Rregullorja për certifikimin e përkthyesve dhe interpretëve gjyqësor në	Është miratuar.	Përbushur.

		gjqësore, e miratuar (akt nënligjor i ri)				procedura gjyqësore		
33.	Të zbatohen dispozitat e MSA - së në fushën e gjyqësorit (neni 83)	Rregullore për certifikimin e përkthyesve dhe interpretëve gjyqësor në procedura penale, e harmonizuar me Kodin e Procedurës Penale të Kosovës (akt nënligjor i ri)	N/A	KGJK	K1 – 2016	A është harmonizuar rregullorja e certifikimit të përkthyesve dhe interpretëve gjyqësor me kodin e procedurës penale?	Masa është në realizim e sipër.	Pjesërisht.
34.	Të zbatohen dispozitat e MSA - së në fushën e gjyqësorit (neni 83)	Rregullore për shpenzimet e dëshmiratrëve gjatë procedurës penale, e miratuar (akt nënligjor i ri)	N/A	KGJK GJKATA	K1 – 2016	A është miratuar Rregullore për shpenzimet e dëshmiratrëve gjatë procedurës penale?	– Masa është në realizim e sipër.	Pjesërisht.
35.	Të zbatohen dispozitat e MSA - së në fushën e gjyqësorit (neni 83)	Rregullore për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit Prokurorial të Kosovës, e miratuar (akt nënligjor i ri)	N/A	KPK	K1 – 2016	A është miratuar rregullorja për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit Prokurorial të Kosovës?	Është miratuar në vitin 2015.	Përmbushur.
36.	Të zbatohen dispozitat e MSA - së	Rregullore për avancimin e	N/A	KPK	K1 – 2016	A është miratuar rregullorja për	Është miratuar.	Përmbushur.

	në fushën e gjyqësorit (neni 83)	prokurorëve, e miratuar (akt nënligjor i ri)				avancimin e prokurorëve?		
37.	Të zbatohen dispozitat e MSA - së në fushën e gjyqësorit (neni 83)	Rregullore për vlerësimin e performancës gjatë mandatit fillestar, e miratuar (akt nënligjor i ri)	N/A	KPK	K1 – 2016	A është miratuar rregullorja për vlerësimin e performancës gjatë mandatit fillestar?	Është miratuar.	Përmbushur.
38.	Të zbatohen dispozitat e MSA - së në fushën e gjyqësorit (neni 83)	Rregullore për organizimin dhe Strukturën e Sekretariatit të KPKsë, e miratuar (akt nënligjor i ri)	N/A	KPK	K1 – 2016	A është miratuar rregullorja për organizimin dhe Strukturën e Sekretariatit të KPK-së?	Nuk është miratuar.	Paplotësuar.
39.	Të zbatohen dispozitat e MSA - së në fushën e gjyqësorit (neni 83)	Rregullore për ndarjen e lëndëve, e miratuar (akt nënligjor i ri)	N/A	KPK	K1 – 2016	A është miratuar rregullorja për ndarjen e lëndëve?	Është miratuar me 2015.	Përmbushur.
40.	Të zbatohen dispozitat e MSA - së në fushën e gjyqësorit (neni 83)	Rregullore për provimin e prokurorëve, e miratuar (akt nënligjor i ri)	N/A	KPK	K1 – 2016	A është miratuar rregullorja për provimin e prokurorëve?	Është aprovuar Rregullorja Nr.07 për Rekrutimin, Provimin, Emërimin dhe Riemërimin E Prokurorëve Të Shtetit, më 2015.	Përmbushur.
41.	Të zbatohen dispozitat e MSA - së në fushën e të drejtave themelore dhe mbrojtjes së	Rregullore për kthimin e personave të zhvendosur, e miratuar (akt		MKK	K1 – 2016	n/a	n/a	n/a

	minoriteteve (neni 3 dhe neni 4)	nënligjor i ri)						
42.	Të zbatohen nenet 85, 86, 87 dhe 88 të MSA-së në fushën e migracionit	Të përmirësohet edhe më tej bashkëpunimi ndërkombëtar në fushën e ripranimit	1. Marrëveshja për ripranim me Turqinë, nënshkruar	1. MPB, MPJ	K1 – 2016	A është nënshkruar marrëveshja për ripranimin me Turqinë?	Marrëveshja për "Ripranimin e Personave që Qëndrojnë pa Autorizim," ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Turqisë është finalizuar dhe nënshkruar me datën 15.12.2015 në Prishtinë.	Përbushur.
43.	Të zbatohet neni 91 i MSA -së në fushën fushën e luftimit të krimin të organizuar	Të përmirësohet edhe më tej bashkëpunimi ndërkombëtar në fushën e luftimit të krimin të organizuar dhe bashkëpunimit policor	1. Marrëveshja për bashkëpunim policor me Turqinë, nënshkruar r2. Marrëveshja për bashkëpunim policor me Estoninë, nënshkruar 3. Marrëveshjet për bashkëpunim policor me Italinë, Belgjikën, Danimarkën dhe Lituaninë, të inicuar	1. MPB, MPJ2. MPB, MPJ3. MPB, MP	K1 – 2016	A është nënshkruar marrëveshja për bashkëpunim policor me Turqinë dhe me Estoninë?	Marrëveshjet për bashkëpunim policor me Turqinë dhe Estoninë janë finalizuar, pritët caktimi i datave për nënshkrim për të dy marrëveshjet.	Pjesërisht.
44.	Të zbatohen dispozitat e MSA-së	Rregullorja për integrimin e të	N/A	MPB	K1 – 2016	A është nxjerrur rregullorja për	Grupi Punues për hartimin e Draftit	Ligji nuk është miratuar

	në fushën e migracionit (neni 85, 86, 87 dhe 88)	huajve, miratuar (rregullore e re)				integrimin e të huajve?	<i>fillestar të Rregullores për Integrimin e të Huajve është themeluar në fund të nëntorit 2015 dhe është hartuar drafti fillestar. Ky draft pritet të miratohet pas plotësim-ndryshimit të ligjit për të Huajt, në mënyrë që të reflektohen ndryshimet edhe në draft Rregullore.</i>	ende, rrjedhimisht, objektiva ngelet e Pajlotësuar.
45.	Zbatimi i nenit 107 të MSA -së	Udhëzimi Administrativ për Licencimin e e revistave shkencore (Akt - nënligjor i ri)	N/A	MASHT	K1 – 2016	A është nxjerrur UA për licencimin e revistave shkencore?	Udhëzimi është hartuar dhe ndodhen në Kabinetine ministrit për nënshkrim.	Pjesërisht.
46.	Zbatimi i nenit 107 të MSA –së	Udhëzimi Administrativ për përsosjen shkencore të shkencëtarëve të rinjë (Akt - nënligjor i ri)	N/A	MASHT	K1 – 2016	A është nxjerrur UA për përsosjen shkencore të shkencëtarëve të rinjë?	Udhëzimi është hartuar dhe ndodhet në Kabinetine ministrit për nënshkrim.	Pjesërisht.
47.	Zbatimi i nenit 118 të MSA –së	Ligji Nr. 04/L - 037 për Arsimin e Lartë (plotësim - ndryshim)	N/A	MASHT	K1 – 2016	A është miratuar ligji për Arsimin e Lartë (plotësim-ndryshim)?	Ligji për Arsimin e lartë është planifikuar që të paraqitet në Kuvend perseri në	Pajlotësuar.

							muajin Qershor.	
48.	Zbatimi i nenit 118 të MSA -së	Ligji për Profesionet e Rregulluara (ligji i ri)	Direktiva 2005/36/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit të 7 shtatorit 2005 mbi njohjen e kualifikimeve profesionale, 32005L0036	MAShT	K1 – 2016	A është miratuar Ligji për Profesionet e Rregulluara?	Ligji për Profesionet e Rregulluara është në komisionin e arsimit nëKuvendin e Kosovës.	Pjesërisht.
49.	Të zbatohen dispozitat e MSA - së për nenin 115 për mjedisin, nenin 116 për ndryshimet klimatike dhe nenin 117 për mbrojtjen civile	Ligji për infrastrukturë dhe informatat hapësinore (ligji i ri)	Direktiva 2007/2/KE për themelimin e infrastrukturës për informim hapësinor – INSPIRE	MMPH MSh MTI BPZHR Komunat	K1 – 2016	A është miratuar ligji për infrastrukturë?	Nuk kemi pranuar informata nga asnjëri nga institucionet. Sidoqoftë, ligji nuk ka kaluar dhe nuk mund të gjindet asnjë projektligji.	Paplotësuar.
50.	Të zbatohen dispozitat e MSA - së për nenin 115 për mjedisin, nenin 116 për ndryshimet klimatike dhe nenin 117 për mbrojtjen civile	UA nr. 07/2009 për administrimin e mbeturinave që përmbajnë azbest (plotësim ndryshim)	Direktiva 87/217/EEC/ për parandalimin dhe reduktimin e ndotjes së mjedisit nga asbesti	MMPH MZHE MTI MSh Komunat	K1 – 2016	A është bërë plotësim ndryshimi i UA nr.07/2009 për administrimin e mbeturinave që përmbajnë azbest?	Nuk kemi pranuar informata nga asnjëri nga institucionet.	/
51.	Të zbatohen dispozitat e MSA - së për nenin 115 për mjedisin, nenin 116 për ndryshimet klimatike dhe nenin 117 për mbrojtjen	UA nr. 06/2006 për strukturën e pagesave të ujit (plotësim ndryshim)	Direktiva kornizë për ujërat 2000/60/KE	MMPH MZHE ME Kompanitë e Ujit (KRU) Bizneset	K1 – 2016	A është bërë plotësim ndryshimi i UA nr. 06/2006 për strukturën e pagesave të ujit?	Nuk kemi pranuar informata nga asnjëri nga institucionet.	/

	civile							
